

VENDIM
Nr. 28, datë 4.11.2022

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, të ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”; kreu II, neni 4, pika “a”, “c”; dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 3.5.2018 të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, të ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 28, datë 4.11.2022, si më poshtë:

1. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Dosje formulare nr. 794**, në ngarkim të B.B., me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë, ndër të cilat 35 (tridhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit të Arratisur.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula